

FTESË PËR NEGOCIATA

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë
Tel/Fax+355 04 225 8977
E-mail mail@kesh.al
Adresa e Internetit www.kesh.al

I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:
Emri
Adresa Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë
Tel/Fax +355697070248
E-mail

Autoriteti Kontraktor KESH sh.a do të zhvillojë “FUSHATË INFORMUESE DHE EDUKUESE TË QYTETARËVE/FAMILJEVE MBI PËRDORIMIN APO KURSIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË KUSHTET E VËSHTIRËSISË NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE SI PASOJË E RRRITJES SË ÇMIMEVE NË TREGJET RAJONALE TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.

Nevoja për kryerjen e botimit:

Në referim të legjislacionit dhe në kushtet e detyrimit për furnizimin e konsumatorëve familjarë me energji elektrike, duke ndjekur më vëmendje zhvillimet në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare të tregtimit të energjisë elektrike, dhe vlerësim të situatës, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare do të ndërmarrë iniciativën e një fushate informuese dhe edukuese për përdorimin e energjisë elektrike në çdo familje. Në këtë mënyrë mendojmë se informacioni i kësaj fushate do të hyjë në çdo familje shqiptare për të kthyer vëmendjen e duhur, në përdorimin sa më eficient të energjisë elektrike në familje apo dhe në ambientet e punës së përditshme. Objektivi i përgjithshëm i kësaj fushate është informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi për përdorimin e përditshëm të energjisë elektrike. Realizimi i kësaj fushate do të kryhet nëpërmjet

spoteve TV dhe Radio, si dhe materialeve digjitale, ku mesazhi i dhënë duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm nga opinioni i gjerë dhe nga të gjithë grup moshat apo përdoruesit e energjisë.

Qëllimi i kësaj fushate është kthimi i vëmendjes së konsumatorit të energjisë elektrike në familje mbi vështirësinë që sot po përballet sistemi elektroenergjetik shqiptar si rezultat i situatës së krijuar nga rritja tej çdo parashikimi e çmimeve të energjisë elektrike në tregun e lirë, si dhe pritshmëria e ulët nga prurjet hidrike si burim kryesor i prodhimit të energjisë në vend, duke u sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar në përdorimin sa më eficient të energjisë elektrike.

Objekti: Zhvillimi i fushatës informuese, edukuese dhe ndërgjegjësuere të qytetarëve/familjeve mbi përdorimin apo kursimin e energjisë elektrike në kushtet e vështirësisë në furnizimin me energji elektrike si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet e energjisë elektrike”.

Shpeshhtësia e shfaqjes së fushatës informuese dhe edukuese: Deri më 31.12.2022

Fondi limit i përcaktuar: 24,940,000 lekë (pa tvsh);

Përmbajtja dhe kriteret teknike të produkteve :

1.1 Spoti televiziv i prodhuar duhet të nxjerrin në pah nevojën për te ndërgjegjësuar publikun e gjere për përdorim sa me te përgjegjshëm t energjisë elektrike dhe kursimin e saj sipas strategjisë së komunikimit të aprovuar më parë.

Spoti duhet të ketë këto karakteristika:

- Të ketë disa skena dhe minimalisht 2 personazhe.
- Jo i animuar por mund të përmbajnë animacione të formës grafike;
- Audio/narracion shoqërues;
- Kohëzgjatja: jo me e vogël se 30 sekonda

Operatori duhet të marrë përsipër:

- Ideimin dhe krijimin e spotit;
- Regjistrimin, pastrimin dhe montimin e zërit narrativ;
- Shoqërimin e zërit me muzikë shoqëruese dhe efekte të tjera audio;
- Muzika duhet të jetë origjinale ose e shoqëruar me të drejtat e përdorimit;
- Renderizimin e spotit në format 4x3 (SD) dhe format 16X9 (SD dhe HD) i gatshëm për transmetim;
- Dorëzimin e spotit në 3 DVD, në format origjinal të pakonvertuar.

Përpara përgatitjes së spotit operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një storyboard.

1.2 Spot Radiofonik me regjistrim audio dhe muzike si dhe minimalisht një zë radiofonik.

1.3 Mbulimi i mesazhit të fushatës në rrjete sociale. Publicitete ne rrjetet sociale përmes postimeve të dedikuara ku secili postim duhet të arrij një reach minimal 200,000 shikime të shtrira në periudha të ndryshme kohore brenda kohëzgjatjes së kontratës.

1.4 Video Tutoriale. Konceptim, prodhim dhe transmetim i video tutorialeve për shpjegimin e rëndësisë së kursimit dhe përdorimit efikas të energjisë.

Rezultatet që duhet të arrihen nga kontraktori

Në përfundim të fushatës, kontraktori duhet të përmbushë detyrat e listuara më poshtë;

	Emertimi	Pershkrimi	NJESIA	SASIA
1	Konceptimi i fushates	Konceptimi i fushates si dhe dorëzimi i raporteve periodike të ecurisë së fushates (përfshirë statistika aty ku aplikohet), sipas kërkesës së autoritetit kontraktor e vlefshme për periudhën Shtator - Dhjetor 2022 me qëllim arrijtjen e objektivave për fazën e parë të ndergjegjesimit.	Cope	1
2	Konsulence Strategji dhe Zhvillim Plani Komunikimi	Sherbim për menaxhimin dhe monitorimin mediatik, menaxhimin e marrëdhënive me publikun përfshi publikimin e materialeve edukuese, informative në format artikujsh, kronikash, intervistash dhe aktiviteteve me grupet e interesit dhe specialiste të fushës energjitike dhe ekonomise.	Sherbim mujor	3
3	Prodhim Spoti Televiziv	Spoti i prodhuar duhet të nxjerrin në pah nevojën për të ndergjegjesuar publikun e gjere për përdorim sa më të përgjegjshëm të energjisë elektrike dhe kursimin e saj sipas strategjisë së komunikimit të aprovuar më parë. Spoti duhet të ketë këto karakteristika: <ul style="list-style-type: none"> - Të ketë disa skena dhe minimalisht 2 personazhe. - Jo i animuar por mund të përmbajnë animacione të formës grafike; - Audio/narracion shoqërues; - Kohëzgjatja: jo më e vogël se 30 sekonda <p>Operatori duhet të marrë përsipër:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ideimin dhe krijimin e spotit; - Regjistrimin, pastrimin dhe montimin e zërit narrativ; - Shoqërimin e zërit me muzikë shoqëruese dhe efekte të tjera audio; 	Cope	1

		<ul style="list-style-type: none"> - Muzika duhet të jetë origjinale ose e shoqëruar me të drejtat e përdorimit; - Renderizimin e spotit në format 16X9 (HD) i gatshëm për transmetim; - Dorëzimin e spotit në 3 DVD (ose USB), në format origjinal të pa konvertuar. <p>Përpara përgatitjes së spoteve operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një 'storyboard'.</p>		
4	Prodhim Spoti Radiofonik	Spot Radiofonik me regjistrim audio dhe muzike si dhe minimalisht një zë radiofonik.	Cope	1
5	Transmetim Spoti ne TV	Transmetimi i spotit televizive secili në 3 kanale kryesore në vend, të mbështetura nga 3 ose me shume kanale informative (ndër më të ndjekurat), ku një nga spotet te jete ndërmjet fashës orare 15:30 – 23:00 te shtrira ne periudha te ndryshme kohore brenda kohëzgjatjes se kontratës.	Spote 30" Ekuivalente	330
6	Transmetim Spoti ne Radio	Transmetimi i spotit radiofonik në minimumi 3 radio kombëtare. Frekuenca jo më pak se 2 herë në ditë, ku të paktën njëri të jetë mes fashës orare 07.00 – 09.00 dhe të paktën një tjetër mes fashës 16.00 – 18.00.	Nr Spotesh	300
7	Publicitet ne Social Media	Publicitete ne rrjetet sociale përmes postimeve te dedikuara ku secili postim duhet të arrij një reach minimal 200,000 shikime te shtrira ne periudha te ndryshme kohore brenda kohëzgjatjes se kontratës	Nr. Postimesh	10
8	Video Tutoriale	Konceptim, prodhim dhe transmetim i video tutorialeve për shpjegimin e rëndësisë se kursimit dhe përdorimit efikas te energjisë.	Cope	10

Afati i fundit për paraqitjen e konfirmimeve nga organet e medias/ agjencitë e specializuara është deri më **dt. 09.09.2022, në orën 15.00**, në adresën zyrtare të autoritetit kontraktor.

Përzgjedhja dhe vlerësimi i ofertave:

Përzgjedhja e ofertave sipas pikës nr. 7 dhe 12 te VKM nr. 1195 datë 05.08.2008

Konfirmimet: Konfirmimet duhet të vijnë në gjuhën shqipe dhe në adresën zyrtare të autoritetit kontraktor brenda afatit të përcaktuar në këtë ftesë :

Emri KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare)
Adresa Rr. Viktor Eftimiu, Blloku Vasil Shanto, Tiranë
Tel/Fax+355 04 225 8977
E-mail mail@kesh.al
Adresa e Internetit www.kesh.al

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit tonë kontraktor së bashku me konfirmimet tuaja dhe dokumentacionin ligjor si më poshtë vijon:

1. Ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit dhe ekstraktin mbi historikun e subjektit, në të cilin duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë fushatën e marketingut/prodhim dhe shpërndarje spotesh dhe reklamash promovionale. Ofertën, ku të jetë specifikuar oferta për zhvillimin e fushatës informuese dhe edukuese.
2. Nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
3. Nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
4. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
5. Nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
6. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore.
7. Shërbime të së njëjtës natyrë, të realizuara gjatë dy viteve të fundit, për këtë të paraqitet kontratë dhe vërtetim realizimi dhe /ose faturë tatimore.
8. Ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
9. Deklaratë për përmbushjen e kriterëve teknike, nga subjekti për zhvillimin e fushatës informuese dhe edukuese dhe përpara përgatitjes, ofertuesi duhet të prezantoj një ide nëpërmjet një storyboard-i.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e vlerësimit të ofertave përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertuesit duhet të dorëzojnë kërkesën origjinale dhe dokumentacionin (original ose fotokopje të noterizuar) përkatës, të futur në një zarf jo transparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e ofertuesit.

Ofertat duhet të dërgohen në datën dhe orën e përcaktuar

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negocim.

KRYETAR I KOMISIONIT